



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.476/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.476/2026, të datës 27.04.2026, të parashtruar nga ankuesit: D.S, P.K, A.S, A.D, K.M, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.476/2026, e datës 27.04.2026 e parashtruar nga ankuesit: D.S, P.K, A.S, A.D, K.M, ashtu që, **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesave të ankueseve të datave 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026 dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, D.S, P.K, A.S, A.D, K.M, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), me datë 27.04.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me heshtjen administrative të Ministrisë së Shëndetësisë ndaj kërkesave të datave 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

30.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 08.05.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2097/2026 të datës 27.04.2026 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përfshirje në shtesat e profesionisteve shëndetësore të datave 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026; Akt emërimet e përshkrimi i detyrave diplomat dhe ID identifikuese të ankuesve; Listat e pagave; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.05.2026.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse:*

Gjendja e fakteve

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit kanë statusin e nëpunësit civilë rrjedhimisht, Ankuesja, D.S. sipas Akt emërimit të datës 09.01.2025, ushtron pozitën *Zyrtar i Lartë për Sëmundje jo Ngjitëse* në Ministrinë e Shëndetësisë; Ankuesi, P.K. sipas Akt emërimit të datës 23.12.2024, ushtron pozitën *Zyrtar i Lartë për Shërbime Emergjente/Urgjente* në Ministrinë e Shëndetësisë; Ankuesja, A.S. sipas Akt emërimit të datës 03.03.2025, ushtron pozitën *Zyrtar për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës* në Ministrinë e Shëndetësisë; Ankuesja, A.D. sipas Akt emërimit të datës 03.03.2025, ushtron pozitën *Zyrtar i Lartë për Kujdesin Shëndetësor Dytësor dhe Tërësor* në Ministrinë e Shëndetësisë; Ankuesja, K.M. sipas Akt emërimit të datës 10.03.2025, ushtron pozitën *Zyrtar për Kujdesin Shëndetësor Parësor* në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ankueset, A.D. dhe A.S, më datë 18.02.2026 i janë drejtuar Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë me Shkresën/Kërkesë për përfshirjen në shtesat e profesionisteve shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankuesit, D.S. dhe P.K. më datë 20.02.2026 i janë drejtuar Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë me Shkresën/Kërkesë për përfshirjen në shtesat e profesionisteve shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankuesja K.M, më datë 23.02.2026 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë me Shkresën/Kërkesë për përfshirjen në shtesat e profesionisteve shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ndërsa, sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve në ankesë organi i punësimit nuk ka dhënë përgjigje në kërkesën e ankuesëve të datës 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026.

Pretendimet ankimore

Ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se të njëjtëve nuk i është kthyer përgjigje nga institucioni ku punon lidhur me kërkesën për përfshirjen në shtesat e profesionisteve shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë. Kërkojnë që të aprovohet ankesa, që organi i punësimit me akt administrativ të trajtojë kërkesat dhe të përfshijë shtesën e profesionistëve shëndetësor, trajtim të barabarte, si dhe në përputhje me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, po ashtu kërkojnë që të bëhet kompensimi edhe në mënyrë retroaktive.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesat e datave 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026 të parashtruar nga ankuesit, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërës prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale dhe si rrjedhojë të detyrojë Njësinë e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesat e ankuesve të datave 18.02.2026, 20.02.2026 dhe 23.02.2026 dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.476/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve P.K;*
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe*
- Arkivit të KPMSHCK-së;*